



Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare



Komisioni Evropian*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT


3 KORRIK 2023

** Vrojtimet e besimit bashkë-financohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato u përfshinë në Programin e Komisionit Evropian për Harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit. Nga muaji qershor 2021, publikimi i analizave dhe të dhënave nga vrojtimet bëhet me frekuencë mujore.*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) regjistroi rritje me 0.8 pikë në muajin qershor. Aktualisht, niveli i TNE-së qëndron 19.6 pikë mbi mesataren afatgjatë, niveli më i lartë historik (Grafik 1). Rritja e TNE-së u përcaktua nga rritja e besimit në sektorët e *industrisë, ndërtimit e tregtisë* si dhe nga përmirësimi i besimit *konsumator* (Grafik 2).

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Treguesi i besimit të industrisë (TBI) u rrit me 1.2 pikë përqindje në muajin qershor, i ndikuar pozitivisht nga vlerësimet optimiste për *kontratat porositëse*, kryesisht atyre të eksporteve. Niveli i TBI-së aktualisht qëndron rreth 20 pikë përqindje mbi mesataren historike (Grafiku 2). Ndërkohë, pritjet e bizneseve të industrisë për *prodhimin* dhe për *punësimin* në të ardhmen janë ulur. Pritjet e tyre për çmimet që do të vendosin në të ardhmen kanë vijuar prirjen rritëse të muajve të fundit (Tabelë 2, sektori i industrisë).

Treguesi i besimit në ndërtim (TBN) u rrit me 2.2 pikë përqindje në muajin qershor, duke shënuar nivelin më të lartë historik. Ky tregues qëndron 37 pikë përqindje mbi nivelin e mesatares afatgjatë (Grafik 2). Rritja këtë muaj u përcaktua si nga vlerësimet më të mira për *aktivitetin aktual ndërtues* ashtu dhe për nivelin e *porosive* aktuale. Ndërkohë, si pritjet për punësimin ashtu edhe ato për çmimet në të ardhmen shënuan rritje (Tabelë 2, sektori i ndërtimit).

Grafik 2. Treguesit e besimit sipas sektorëve*



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.
Shënim: *Grafiku paraqet vlera të standardizuara, për të korrigjuar ndryshimet ndërmjet mesatareve dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

Treguesi i besimit në shërbime (TBSH) u ngadalësua me 1.6 pikë përqindje në muajin qershor. Megjithatë, niveli i TBSH-së qëndron rreth 27.5 pikë përqindje mbi mesataren afatgjatë duke shënuar një nga vlerat më të larta historike (Grafik 2). Rënia e komponentit të *ecurisë aktuale të aktivitetit* ka ndikuar dhe në ngadalësimin e treguesit të besimit të sektorit përkatës. Ndërkohë, niveli i kërkesës ka regjistruar përmirësim. Pritjet e bizneseve për *kërkesën dhe punësimin në të ardhmen* janë pothuajse në të njëjtat nivele me aktualen. Pritjet e tyre për *ecurinë e çmimeve në të ardhmen* nuk kanë pësuar ndryshime të rëndësishme në krahasim me muajin e kaluar (Tabelë 2, sektori i shërbimeve).

Treguesi i besimit në tregti (TBT) vijoi prirjen rritëse, me rreth 0.7 pikë përqindje në këtë muaj. Kjo lëvizje u ndikua kryesisht nga vlerësime shumë optimiste mbi *ecurinë e punësimin në të ardhmen* të biznesit. Niveli aktual i TBT-së qëndron rreth 15 pikë përqindje mbi mesataren historike (Grafik 2). Gjithashtu, pritjet për *ecurinë e punësimin në të ardhmen* u vlerësuan me rënie të rëndësishme këtë muaj (Tabelë 2, sektori i tregtisë).

Treguesi i besimit konsumator (TBK) rezultoi i përmirësuar me rreth 0.6 pikë përqindje në muajin qershor. Niveli i tij, prej muajit mars, qëndron mbi mesataren historike, për herë të parë që nga muaji shtator 2021. Përmirësimi i TBK-së këtë muaj u përcaktua nga vlerësimi më pozitiv i tyre për *blerje në shuma të mëdha aktuale* dhe në të ardhmen (Grafik 2). Pritjet për nivelin e përgjithshëm të çmimeve në të ardhmen janë rishikuar për poshtë (Tabelë 2, konsumatorët).


Treguesit me frekuencë tremujore¹ shfaqën një ecuri pozitive me bazë të gjerë sektoriale për treguesin e *gjendjes financiare të bizneseve* krahasuar me rezultatet e vrojtimeve të tre muajve më parë. *Gjendja financiare e bizneseve* u përmirësua gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, në sektorin e industrisë

¹ Pyetjet mbi normën e shfrytëzimit të kapaciteteve dhe gjendjen financiare kanë frekuencë tremujore. Ato përfshihen në pyetësorët e bizneseve të muajve mars, qershor, shtator dhe dhjetor.

(+8.8 pikë përqindje), ndërtimit (+4.7 pikë përqindje), shërbimeve (+7.9 pikë përqindje) dhe tregtisë (+6.6 pikë përqindje).


Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve shënoi rritje në sektorët e shërbimeve (+0.5 pikë përqindje, në nivelin 82%) dhe tregtisë (+0.3 pikë përqindje, në nivelin 77%). Ndërkohë, në sektorin e ndërtimit ky tregues mbeti i pandryshuar në vlerën 76%. Ky tregues rezultoi lehtësisht me rënie në sektorin e industrisë (-0.4 pikë përqindje, duke zbritur në 81.3%).

Grafik 3. Situata e biznesit sipas sektorëve, gjatë muajve të fundit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për situatën e biznesit gjatë muajve të ardhshëm




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Pritjet për papunësinë dhe çmimet e konsumatorëve për 12 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Blerjet në shuma të mëdha të konsumatorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit e besimit sipas sektorëve*

	Vlerat			2023						Situata aktuale	
	min	mes	max	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Koniunkturale**	Strukturore***
Industri	-60.2	-10.1	8.9	-7.0	-4.0	2.1	5.1	7.6	8.9	↑	++
Ndërtim	-57.8	-23.9	11.0	-7.3	-0.9	2.8	3.3	8.8	11.0	↑	++
Shërbime	-45.4	8.4	36.2	20.5	17.4	26.5	25.2	36.2	34.6	↓	++
Tregti	-32.5	-0.6	17.9	3.9	4.7	9.9	11.1	12.6	13.3	↑	++
Konsumator	-40.2	-26.7	-16.3	-30.4	-29.9	-26.5	-24.4	-25.0	-24.4	↑	+

Burimi: Vrojimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga muaji maj 2016.

***) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

****) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (--), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2. Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)

	2022								
	Tetor	Nënt.	Dhjet.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh.
INDUSTRIA									
Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së)	12.9	10.1	14.8	15.4	16.0	21.4	26.2	30.5	28.5
Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së)	-14.7	-17.2	-15.2	-16.3	-9.9	-8.1	-1.3	-3.7	-1.1
Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së)	-18.7	-22.2	-18.6	-20.1	-18.0	-7.1	-9.7	-4.0	-0.8
Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4)	-1.4	-3.9	-5.2	-2.4	-6.0	-1.1	-3.9	-3.7	0.6
Prodhimi pritje (pyetja 5)	32.1	33.7	35.1	33.5	33.1	40.0	38.0	34.0	30.5
Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6)	36.0	31.1	27.0	31.8	18.1	14.9	16.1	17.9	19.4
Punësimi pritje (pyetja 7)	11.0	7.4	7.2	10.9	11.9	15.6	17.9	17.0	13.8
NDËRTIMI									
Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së)	4.2	7.0	12.6	11.9	20.2	22.6	22.1	30.8	32.0
Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së)	-39.7	-27.0	-22.5	-26.5	-22.1	-17.0	-15.6	-13.3	-10.0
Punësimi pritje (pyetja 4)	7.6	16.4	8.3	12.7	19.0	18.8	15.7	14.0	16.5
Çmimet pritje (pyetja 5)	42.6	42.9	32.8	25.8	35.0	28.5	19.5	18.2	26.4
SHËRBIME									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së)	9.7	15.1	16.2	20.1	17.3	25.4	23.8	39.9	33.6
Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së)	12.8	15.4	16.4	20.8	17.4	27.6	26.7	32.5	35.6
Kërkesa pritje (pyetja 3)	19.2	27.3	27.3	33.2	32.4	36.8	29.7	29.7	29.2
Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4)	5.7	3.9	5.1	10.2	5.5	9.6	12.4	16.9	17.1
Punësimi pritje (pyetja 5)	5.3	8.6	7.1	7.5	16.1	20.7	9.7	13.6	13.4
Çmimet pritje (pyetja 6)	30.5	21.0	21.0	24.4	20.0	19.8	8.2	12.9	12.5
TREGTIA									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së)	-0.1	1.2	2.5	3.8	6.2	14.6	16.5	21.6	20.7
Gjendja e inventarëve (pyetja 2)	1.0	3.3	3.1	2.1	5.6	2.6	3.9	5.1	0.7
Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3)	14.9	18.0	21.9	23.9	23.8	25.3	30.6	23.8	26.1
Ecuria e biznesit pritje (pyetja 4)	15.9	23.0	28.1	27.3	26.6	26.8	27.3	27.1	27.4
Pritje për ecurinë e punësimit (pyetja 5, komponent i TBT-së)	2.3	2.8	5.6	4.0	3.2	5.3	5.7	3.7	5.9
Pritje për ecurinë e çmimeve (pyetja 6)	30.9	28.7	24.8	21.9	15.2	13.4	10.4	23.1	11.3
KONSUMATORI									
Situata financiare aktuale (pyetja 1)	-21.0	-19.6	-20.1	-16.5	-16.5	-14.5	-14.9	-13.5	-13.3
Situata financiare pritje (pyetja 2, komponent i TBK-së)	-5.5	-3.6	-3.1	-2.0	0.1	4.3	6.4	5.0	5.0
Situata ekonomike aktuale (pyetja 3)	-32.2	-31.6	-30.2	-27.8	-30.2	-27.5	-24.7	-23.8	-22.3
Situata ekonomike pritje (pyetja 4, komponent i TBK-së)	-13.2	-11.6	-8.7	-6.4	-4.6	0.5	2.5	3.4	1.9
Çmimet aktuale (pyetja 5)	53.9	49.0	46.5	49.3	46.6	45.7	49.1	43.6	45.8
Çmimet pritje (pyetja 6)	2.9	-3.4	-10.4	-1.9	-4.1	-6.5	-4.5	-8.2	-6.4
Papunësia pritje (pyetja 7)	14.3	8.2	10.4	9.0	11.2	2.9	-1.2	-1.8	-1.2
Blerjet e mëdha aktuale (pyetja 8, komponent i TBK-së)	-66.6	-66.2	-64.7	-66.1	-62.9	-62.6	-59.0	-59.9	-57.4
Blerjet e mëdha pritje (pyetja 9, komponent i TBK-së)	-54.1	-52.6	-49.8	-47.0	-52.1	-48.3	-47.8	-48.5	-47.3
Kursimi aktual (pyetja 10)	-48.1	-48.1	-42.2	-48.3	-50.4	-44.5	-41.9	-42.4	-42.9
Kursimi pritje (pyetja 11)	-44.4	-42.2	-41.1	-41.8	-44.2	-40.0	-39.9	-39.3	-38.9
Situata e të ardhurave dhe shpenzimeve (pyetja 12)	0.7	2.1	1.6	1.7	3.1	4.1	3.4	4.4	3.3

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

ANEKS

Shpjegime metodologjike

Balanca është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vërtetimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

Treguesi i Besimit (TB) ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE) ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para agregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.